



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 859/1 Prot.

Tiranë, më 10. 06. 2022

**V E N D I M**

**Nr. 113, datë 10. 06. 2022**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 93, datë 03.06.2022, të paraqitur nga N. H., kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore<sup>1</sup>, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “moshës” dhe “çdo shkak tjetër<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e sjellë pranë KMD-së, rezulton se subjekti ankues, N. H., aktualisht është përfitues i pensionit të pleqërisë.

Ankuesi është shprehur ndër të tjera se: “...kam qenë i punësuar për shumë vite në Bazën Detare në Pashaliman deri në vitin 1991. Në këtë bazë kam punuar me lëndë kimike dhe për këtë arsye më është dhënë nga ana e ish punëdhënësit vështirësia në punë.

Me kërkesë datë 20.10.2021 i jam drejtuar Bazës Detare të Pashalimanit të më japë një vërtetim lidhur me vështirësitë e punës që unë kam kryer në këtë bazë.

Me shkresën nr. 746, datë 01.11.2021 nga ana e Bazës Detare Pashaliman më është kthyer përgjigje se në administratën e kantierit të bazës nuk disponohet dokumentacion për këtë periudhë. Megjithatë, në librezën e punës (që e disponojnë sigurimet shoqërore është e pasqyruar periudha e punës me specifikat përkatëse).

Arsyeja që i drejtohem institucionit tuaj është se nuk kam gjetur zgjidhje, pavarësisht ankesave dhe kërkesës sime të vazhdueshme për të drejtën e shkelur.

Nuk jam dakord me masën e pensionit pasi nuk më kanë llogaritur vështirësinë në punë, pavarësisht se Komisioni Qendror i Ankimit Tiranë, ka lënë në fuqi vendimet e ISSH Fier dhe

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën ISSH.

<sup>2</sup> Për shkak se është i vetëm dhe pa mbështetje, pasi jeton në Shtëpinë e të Moshuarve Fier.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

*ISSH Vlorë, ku më janë mohuar 7 vite vështirësi në punë, dhe kjo padrejtësi më ka vendosur në situatë diskriminuuese pasi kolegët e mi të asaj kohe, të cilët kanë kryer të njëjtën punë si unë, e kanë përfitur.*

*Po ju rendit disa emra të kolegëve si më poshtë: M. A., A. D., N. K., P. Z., K. D. ”.*

Në përfundim të parashtrimeve ankuesi pretendon se: *“Unë trajtohem ndryshe se jam i vetëm, pa mbështetje, pa të ardhura pasi jetoj në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, a mjafton më për mua koha të vendoset në vend e drejta e shkelur?! Dua ndërhyjen tuaj, për të trajtuar çështjen time, si institucioni i vetëm përgjegjës për të luftuar diskriminimin, pasi unë nuk kam as fuqi financiare as fizike të ndjek çështjen, për një të drejtë që jam bindur që është abuzuar për shkak të moshës sime dhe faktit që jam i vetëm pa mbështetje.”.*

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për shkak të moshës dhe faktit që është i vetëm pa mbështetje.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar<sup>4</sup>, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

<sup>4</sup> Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

*Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, konstatohet se:*

- Me Vendimin nr. 490, datë 06.03.2014, DRSSH Vlorë i ka caktuar ankuesit pension pleqërie të pjesshëm, me periudhë sigurimi 26 vjet me bazë mesatare mujore e vlerësuar mbi të cilën llogaritet pensioni minimal me të drejtë pagese nga data 02.03.2014 e përgjithmonë, në masën 16.403 lekë.
- Ankuesi nuk ka qenë dakord me masën e pensionit të caktuar nga DRSSH Vlorë dhe e ka kundërshtuar atë pranë Komisionit Rajonal të Ankimimit, pranë DRSSH Fier.
- Komisioni Rajonal i Ankimimit, pranë DRSSH Fier, pasi ka shqyrtuar ankimimin e N. H., nëpërmjet Vendimit nr. 1035, datë 21.12.2021, ka vendosur të rrëzojë kërkesën e tij dhe të lërë në fuqi Vendimin nr. 490, datë 06.03.2014 të DRSSH Vlorë.
- Ankuesi ka kundërshtuar Vendimin e Komisionit Rajonal të Ankimimit pranë DRSSH (KRA) Fier, në Komisionin Qendror të Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISHSH), i cili, nëpërmjet Vendimit nr. 375, datë 21.04.2022, pasi ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit, ka vendosur të rrëzojë kërkesën e tij dhe të lërë në fuqi Vendimin nr. 1035, datë 21.12.2021 të KRA Fier. Në përfundim, në Vendimin e Komisionit Qendror të Ankimit të ISSH-së, citohet ndër të tjera se: “...3. Në bazë të nenit 86/3 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), N. H. H., ka të drejtë të kundërshtojë me kërkesë padi në gjykatë vendimin e DRSSH Fier të lënë në fuqi nga KRA Fier dhe KQA Tiranë brenda 45 ditëve nga dita e marrjes dijeni.”

Në analizë të nenit 86 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me të drejtën e ankimimit, parashikohet se:

*“ 1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; Ankimi në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel;*

*2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;*

*3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar.....”*

Në Kapitullin III, të Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, përcaktohen rregullat dhe procedurat për verifikimin e dokumenteve për pension, në të cilën përcaktohet se:

*“1. Verifikimi bëhet nga inspektorët verifikues pranë arkivës së DRSSH-së, ASHV-të ose në subjektet që janë duke kryer aktivitetet ekonomiko-financiar. 2. Objekt verifikimi janë*

*dokumentet që vërtetojnë periudhën e sigurimit dhe pagën..... 6. Procedura e verifikimit është si vijon: - Regjistri themeltar është dokumenti i parë që verifikohet. Nëse regjistri është i parregullt, pa datë fillimi ose pa datë mbylljeje të punës ose kur regjistri themeltar nuk ekziston, verifikimi vazhdon me librin e pagave. Në qoftë se libri i pagave ka parregullsi ose kur libri i pagave nuk ekziston, atëherë verifikimi vazhdon me: Borderotë, listëpagesat. Në mungesë të tyre, verifikimi vazhdon me .....*”.

Referuar në sa më sipër, vlerësohet se, DRSSH Vlorë, Komisioni Rajonal i Ankimit të DRSSH Fier dhe Komisioni Qëndror i Ankimit pranë ISSH-së, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, kanë detyrimin ligjor për të verifikuar dokumentacionin e disponueshëm sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008.

Sikurse vihet re nga parashikimet e pikës 1 të Kapitullit të III të Rregullores “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, janë inspektorët verifikues ato të cilët bëjnë shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit për llogaritjen dhe përfitimin e pensionit nga ana e kërkuesve.

Në analizë për sa më sipër, rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtyre organeve (Komisioneve Rajonale të Ankimit, pranë DRSSH apo Komisioneve Qendrore të Ankimit, pranë ISSH) nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Neni 42 i Kushtetutës vendos standarde kushtetuese si për gjykatat, ashtu dhe për organet e administratës publike. Pika 2 e po këtij neni, sanksionon se kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cënim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar dhe rastin kur cënimi vjen dhe nga një akt administrativ i tillë.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar në ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë<sup>5</sup>”, të ndryshuar; t’i drejtoheni Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të kundërshtuar vendimin e Komisionit Qendror të Ankimit pranë ISSH.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10 21/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

---

<sup>5</sup> Neni 86, pika 3 e tij.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon gjithashtu subjektit ankues, që për problematikën e tij, t'i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike, Fier<sup>6</sup>, ose Shërbimit Ligjor Falas<sup>7</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 93 Regj., datë 03.06.2022, të subjektit ankues N. H., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Moshë dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)

---

<sup>6</sup> Me adresë: Rruga “Ramiz Aranitasi”, pranë ADISA, Fier.

<sup>7</sup> Me adresë: Bulevardi: “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Nr.tel: 0422 53113.